

VENDIM
Nr. 382, datë 12.6.2024

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË PARË, PËR ZBATIMIN E
MARRËVESHJES, PËR KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN E PUNËS
NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të parë, për zbatimin marrëveshjes, për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PROTOKOLL I PARË
**MBI ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË
TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si “Palët kontraktuese” dhe individualisht si “Pala kontraktuese”;

në përputhje me nenin 16 të marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, të nënshkruar më 21 dhjetor 2021, në Tiranë (në vijim e referuar si “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Ky protokoll përcakton kushtet për zbatimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht për caktimin e kriterëve të përbashkëta për regjistrimin e shtetasve të palëve kontraktuese, si dhe çështjet që lidhen me punën dhe vendbanimin e shtetasve të palëve kontraktuese në territorin e palës marrëse.

Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë protokoll do të kuptohen siç përcaktohen në marrëveshje.

Neni 2

Shtetasi i një pale kontraktuese (në vijim i referuar si: aplikanti), në përputhje me nenin 7 të marrëveshjes, do të përdorë shërbimin elektronik online, të krijuar për akses falas në tregun e punës në portalin e qeverisjes elektronike të palës marrëse.

Të dhënat për identitetin elektronik të konfirmuar të personit që aplikon për shërbimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, jepen në përputhje me marrëveshjen për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

Aplikanti duhet t'i dorëzojë palës marrëse si të dhënat e tij/saj personale edhe të dhënat e tjera, në lidhje me rrethanat e punës dhe qëndrimit të tij/saj marrëse.

Të dhënat personale të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, përfshijnë:

1. Numrin e identifikimit (ID) të Ballkanit të Hapur;
2. Emrin dhe mbiemrin;
3. Datën e lindjes;
4. Shtetin e lindjes;
5. Numrin unik të identifikimit vendas të dhënë nga pala kontraktuese, ku ai/ajo është shtetas;
6. Gjininë;
7. Shtetësinë.

Të dhënat e tjera, të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, përfshijnë:

1. Llojin e dokumentit, numrin dhe datën e skadimit (kartë identiteti e vlefshme ose dokument biometrik udhëtimi) dhe kopjen bashkëlidhur të dokumentit;
2. Emrin dhe mbiemrin e babait;
3. Emrin dhe mbiemrin e nënës;
4. Mbiemrin e vajzërisë - nëse është e zbatueshme;
5. Adresën e *email*-it;
6. Numrin e telefonit celular;
7. Adresën ku aplikanti ose banon, ose synon të banojë në palën marrëse;
8. Lejet e mëparshme të qëndrimit të dhëna në palën marrëse;
9. Gjendjen civile;
10. Vetëdeklarimin e statusit gjyqësor në palën kontraktuese, shtetas i së cilës ai ose ajo është;
11. Vetëdeklarimin se nuk përbën rrezik për shëndetin publik;
12. Vetëdeklarimin lidhur me fëmijët e mitur dhe/ose bashkëshortin dhe synimin për bashkim familjar;
13. Vetëdeklarimin mbi burimet financiare për banim në palën marrëse;
14. Vetëdeklarimin lidhur me të dhënat për automjetin e regjistruar jashtë palës marrëse, të cilat ai/ajo synon t'i përdorë në palën marrëse;
15. Foton e fundit, jo më të vjetër se 6 muaj;
16. Informacion rreth punësimit të mundshëm;
17. Informacion për arsimin dhe kualifikimet profesionale.

Pjesë përbërëse e formularit të aplikimit në internet është deklarata e aplikantit se ai/ajo po e dorëzon formularin personalisht, se të gjitha të dhënat e ofruara janë të vërteta dhe se ai/ajo është në dijeni të pasojave të dhënies së informacionit të rremë ose fshehjes së informacionit.

Neni 3

Pala marrëse, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, shqyrton nëse kushtet e përcaktuara në nenin 4 të marrëveshjes janë përmbushur, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit, nëpërmjet shërbimit elektronik online të përmendur në paragrafin 1 të nenit 2.

Pas përfundimit të procedurës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, aplikanti merr njoftim elektronik.

Neni 4

Nëse akses i lirë në tregun e punës është miratuar, aplikanti do të marrë miratimin elektronik për akses të lirë në tregun e punës.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës, i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përfshin:

1. Numrin e identifikimit (ID) të Ballkanit të Hapur;
2. Numrin e aplikimit/miratimit për akses të lirë në tregun e punës;

3. Emrin dhe mbiemrin;
4. Datën e lindjes;
5. Gjininë;
6. Numrin unik të identifikimit vendas;
7. Shtetësinë;
8. Numrin e telefonit celular;
9. Adresën e *email*-it;
10. Llojin e dokumentit, numrin dhe datën e skadimit (kartë identiteti e vlefshme ose dokument biometrik udhëtimi);
11. Periudhën e vlefshmërisë së miratimit për akses të lirë në tregun e punës;
12. Numrin unik ID të shtetasit të huaj, të caktuar nga pala marrëse për aplikantin;
13. Kodin QR që përmban të dhëna që mundëson kontrollin elektronik të vlefshmërisë së miratimit dhe të dhënave të aplikantit;

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës është dokument i vulosur elektronikisht, i lëshuar nga autoritetet e mëposhtme të palëve kontraktuese:

1. Republika e Serbisë – Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i vulosur elektronikisht nga Zyra për Teknologjitë e Informacionit dhe Qeverisjen Elektronike;
2. Republika e Shqipërisë – Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Policia e Shtetit Shqiptar;
3. Republika e Maqedonisë së Veriut – Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës.

Paraqitja dhe përmbajtja e miratimit për akses të lirë në tregun e punës bashkëlidhet këtu dhe është pjesë përbërëse e këtij protokoll (shtojca 1).

Bazuar në dispozitat e nenit 15 të marrëveshjes, secila palë kontraktuese rezervon të drejtën t'i lëshojë dokumente shtesë shtetasit të palës kontraktuese, të cilit i është dhënë akses falas në tregun e punës me kërkesën e tij, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 5

Nëse akses i lirë në tregun e punës nuk është miratuar, aplikanti do të njoftohet në mënyrë elektronike se akses i lirë në tregun e punës refuzohet.

Aplikanti mund të riaplikojë brenda 30 ditëve nga dërgimi i njoftimit për refuzimin e aksesit të lirë në tregun e punës.

Neni 6

Nëse të dhënat e përmendura në nenin 2 të këtij protokoll ndryshojnë, një shtetas i një pale kontraktuese, të cilit i është lëshuar miratimi për akses të lirë në tregun e punës, duhet pa vonesë dhe jo më vonë se 5 ditë pune, nëpërmjet shërbimit elektronik të palës marrëse, të hyjë në aplikimin e tij/të saj të mëparshëm të regjistrimit dhe të përditësojë të dhënat.

Pas përditësimit të të dhënave, ai/ajo do të njoftohet elektronikisht se ndryshimet janë prezantuar me sukses dhe do të marrë miratimin e përditësuar për akses të lirë në tregun e punës.

Nëse ka një ndryshim në të dhënat që lidhen me zbatimin e marrëveshjes (d.m.th. ndryshim të shtetësisë), miratimi për akses të lirë në tregun e punës pushon së qenuri i vlefshëm.

Neni 7

Nëse një shtetas i një pale kontraktuese i është dhënë më parë qëndrimi i përkohshëm në palën marrëse për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në marrëveshje dhe ai/ajo regjistrohet për akses të lirë në tregun e punës, aplikimi do të miratohet nëse kushtet e

përcaktuara nga marrëveshja plotësohen dhe pala marrëse revokon qëndrimin e përkohshëm të dhënë më parë.

Nëse një shtetasi të një pale kontraktuese i është dhënë më parë akses i lirë në tregun e punës në palën marrëse në bazë të marrëveshjes dhe më pas i jepet qëndrim i përkohshëm në palën marrëse me kërkesën e tij/saj, në përputhje me legjislacionin vendas, miratimi për akses të lirë në tregun e punës pushon së qenuri i vlefshëm.

Neni 8

Një shtetas i një pale kontraktuese mund të iniciojë reregjistrimin e përmendur në nenin 7, paragrafi 4 i marrëveshjes, brenda 60 ditëve përpara datës së skadimit të miratimit për akses të lirë në tregun e punës.

Reregjistrimi do të kryhet në të njëjtën mënyrë si regjistrimi i parë, në përputhje me nenin 7 të marrëveshjes dhe me këtë protokoll.

Neni 9

Palët kontraktuese do të ofrojnë shërbimin, lidhur me procesin e aplikimit për akses të lirë në tregun e punës, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe serbe.

Neni 10

Palët kontraktuese do të krijojnë grupin e përbashkët të punës për të diskutuar dhe zgjidhur të gjitha pengesat ligjore dhe teknike që lindin nga zbatimi i marrëveshjes dhe i këtij protokoll.

Palët kontraktuese do të caktojnë secila një person me detyrën për të drejtuar dhe bashkëkryesuar takimet e grupit të përbashkët të punës dhe për të përfaqësuar pikën kryesore të kontaktit për koordinimin dhe zbatimin e këtij protokoll.

Palët kontraktuese mund të caktojnë aq njerëz sa është e nevojshme si anëtarë të grupit të përbashkët të punës për të përmbushur detyrimet e fushave të bashkëpunimit të përcaktuara në marrëveshje dhe në këtë protokoll.

Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve të duhura, për personat e caktuar të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe do shkëmbejnë informacion mbi pikat e kontaktit, jo më vonë se 7 ditë nga data e nënshkrimit të këtij protokoll.

Neni 11

Për secilën palë kontraktuese, ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilën palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet depozituesit, për përfundimin e procedurave, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm për hyrjen në fuqi të këtij protokoll.

Palët mund ta ndryshojnë këtë protokoll me shkrim.

Ky protokoll është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar dhe do të mbetet në fuqi për sa kohë që marrëveshja mbetet në fuqi.

Originali i këtij protokoll do të depozitohet pranë qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, si depozitare e marrëveshjes, e cila do t'i transmetojë një kopje të certifikuar secilës palë kontraktuese.

Bërë në Shkup, më 22 janar dy mijë e njëzet e katër.

NË EMËR TË QEVERISË SË MAQEDONISË SË VERIUT

Vedat Osmani

NË EMËR TË QEVERISË SË SHQIPËRISË
Adela Xhemali

NË EMËR TË QEVERISË SË SERBISË
Gojko Stanivukovic

Shtojcë 1

SKICA DHE PËRMBAJTJA E LEJES UNIKE – MIRATIMI PËR AKSES TË LIRË NË
TREGUN E PUNËS (MADHËSIA A4)



Одобрење за слободан приступ тржишту рада

Број Одобрења / Approval number /
Numri i aprovimit /
Број на одобрување

Approval for free access to labour market

Aprovim për akses të lirë në tregun e punës

Одобрување за слободен пристап до пазар на труд

Презиме / Surname / Имени / Презиме / Име / Name / Emri / Име

**Идентификациони број Отвореног Балкана
Open Balkan ID number
Numri i ID për Ballkanin e hapur
Идентификациски број Отвореног Балкана**

Датум рођења / Date of birth / Ditëlindja / Дата на раѓање

Пол / Gender / Gjaka / Пол

Јединствени матични број грађана / Unique domestic personal ID number /
Numri unik personal i identitetit (i alij vendi) / Единствени матичен број на граѓанинот

Држављанство / Citizenship / Shtetësi / Државјанство

Број мобилног телефона / Mobile phone number / Numër mobil /
Број на мобилен телефон

Имејл адреса / E-mail address / Adresë e mail / Адреса за електронска пошта

Исходни документ / Document / Документ / Исходни документ / Исходни документ /
Dokument origjinal / Исходни документ / Dokument origjinal / Исходни документ /
Исходни документ / Dokument origjinal / Исходни документ / Dokument origjinal / Исходни документ /

**Уникатни идентификациони број странца / Unique
ID number / Numri unik i ID për të huajin /
Исходни матичен број за странец**

**Период важења слободаног приступа тржишту рада /
Validity period of the approval for free access to labor
market / Periudha e vlefshmërisë së aprovimit për akses
të lirë në tregun e punës / Период на важност за
слободен пристап до пазарот на труд**

Електронски документ / Electronic document /
Dokument elektronik / Електронски документ / Dokument elektronik / Електронски документ /

Електронски документ / Electronic document /
Dokument elektronik / Електронски документ / Dokument elektronik / Електронски документ /

Нотарска се издава као електронски документ и одговарајући документ који представља копију / Approval is issued as
electronic document and signed version represents a copy of this document / Approvimi jepohet si dokument elektronik dhe version
priftuar përfaqëson kopje të këtij dokumenti / Нотарска се издава као електронски документ и одговарајући документ од
нотарска представља копија

Нотарска је важећа уз одговарајући документ који доказује идентитет /
Approval is valid with appropriate personal document which proves the identity of the person /
Approvimi është i vlefshëm me dokument personal që vërteton identitetin e personit /
Нотарска је важећа само со одговарајућем документ со кој се докажува идентитет